BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 2900 Prot.
Date 13.05.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 11.05.2026

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkia Maliq

Për shtetasin/en: **Ilir Kallaveresi** me adrese: **Vashtemi**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shpallje vendimin civil nr. 312, dt.14.04.2026, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*,pasi dëftesa e komunikimit eshte e pakonfirmuar e pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Per : Njesia Administrative/ Bashkinë

_____
(emër, mbiemër, firmë)

- Libonik
- 57/149
dt 13.05.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Nr.Regj.Them. 21017-00331-41-2026(56UM) **Nr. vendimi 41-2026-1227(312)**
Data e regjistrimit 23.03.2026 **Datë vendimi 14.04.2026**

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e përbërë nga:

GJYQTARE - Gentiana Shukullari

asistuar prej sekretarit gjyqësor Guri Sofi, në Korçë sot në datën 14.04.2026, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr. regj. themel. 21017-00331-41-2026(56UM) datë ardhje 23.03.2026 që i përket:

PADITËSE: Denisa Mero, e bija e Bardhyl dhe Fatime, e datëlindjes 04.11.1989, banuese në Vashtëmi, bashkia Maliq.

I PADITUR: Ilir Kallavaresi, i biri i Eduart dhe Marjana, i datëlindjes 09.05.1987, banues në Vashtëmi, bashkia Maliq..

OBJEKTI: Vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme të marra me urdhërin nr. 910/2 datë 23.03.2026 të drejtuesit të Komisariatit të Policisë Maliq, lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen, duke u caktuar ndaj të padituri masat mbrojtëse të caktuara me këtë urdhër dhe më pas lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje".

Gjykata, në përfundim të gjykimit, i cili u zhvillua në prani të paditëses e të padituri, pasi dëgjoi palët, të cilët kërkuan:

Paditësja: Lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.

I padituri: Moslëshimin e urdhërit të mbrojtjes,

V Ë R E N:

Paditësja Denisa Mero i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me padinë me objekt: *"Vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme të marra me urdhërin nr. 910/2 datë 23.03.2026 të drejtuesit të Komisariatit të Policisë Maliq, lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen, duke u caktuar ndaj të padituri masat mbrojtëse të caktuara me këtë urdhër dhe më pas lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes."*

Paraprakisht gjykata konstatoi se, kjo mosmarrëveshje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, referuar objektit të padisë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është kompetente nga pikpamja lëndore bazuar në nenin 41 të K. Pr. Civile, si dhe nga pikpamja tokësore bazuar në nenin 29 të ligjit 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", si gjykata e vendbanimit zyrtar të palëve.

Me vendim nr. 56 UM datë 25.03.2026, gjykata ka vendosur lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes për paditësen Denisa Mero, duke vlerësuar masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme të marra me urdhërin nr. 910/2 datë 23.03.2026 të drejtuesit të Komisariatit të Policisë Maliq dhe ka caktuar masat e menjëhershme të mbrojtjes. Referuar parashikimeve të nenit 38 të ligjit nr. 11/2026, gjykata caktoi seancën për vërtetimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes në datën 14.04.2026.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se:

Palët ndërgjyqëse janë bashkëjetues dhe banojnë në fshatin Vashtëmi të bashkisë Maliq në banesën e paditëses, së bashku me prindërit e kësaj të fundit. Ata janë prindër të një fëmije të mitur. Marrëdhëniet midis tyre në vijimësi kanë qënë konfiktuale, dhe për këtë shkak e kanë ndërprerë dhe herë pas here bashkëjetesën.

Në datën 22.03.2026, i padituri ishte kthyer në banesë rreth orës 14:15, pasi kishte dalë më parë rreth orës 10:00, në gjëndje shumë të dehur. Pas kthimit në banesë, ai ka filluar të debatojë me paditësen, duke dhe e fyer me fjalë të rënda këtë të fundit. Ndërkohë, në këtë gjëndje, duke bërtitur, ai ka goditur e përmbysur orenditë shtëpiake. Situata është rënduar edhe më shumë kur i padituri i ka kërkuar paditëses çelësat e makinës për t'u larguar, të cilat ajo i kishte fshehur me qëllim që ai të mos kishte mundësi të lëvizte me të pasi ishte në gjëndje të dehur. Duke qënë se kjo situatë mes tyre ishte e përsëritur edhe herë të tjera sidomos kur i padituri konsumonte pije alkoolike, paditësja ndihej e frikësuar se mos bashkëjetuesi kryente ndonjë veprim më të rëndë ndaj saj apo familjarëve të tjerë lidhur me cënimin fizik, dhe i është drejtuar Komisariatit të Policisë Maliq ku ka pretenduar dhunimin e saj psikologjikisht në mënyrë të përsëritur nga i padituri, duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj saj.

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, në përcaktimin e rrethit të nevojshëm dhe të mjaftueshëm të provave, referuar përcaktimeve të nenit 32 pika 5 dhe 33 të ligjit 11/2026 dëgjoi të dy palët ndërgjyqëse, nga të cilët nuk u paraqit ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve e prapësimeve të tyre.

Paditësja Denisa Mero gjatë kësaj seance parashtroi se, iu qëndronte deklarimeve që kishte dhënë në seancën e lëshimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Gjatë kohës që ishte lëshuar urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes nuk kishte patur ndonjë shqetësim nga i

padituri. Nisur nga konfliktet e vazhdueshme që kishin patur, ajo kërkonte lëshimin e urdhërit të mbrojtjes, me qëllim që të mos shqetësohej nga i padituri.

I padituri Ilir Kavallaresi gjatë kësaj seance parashtroi se, nuk kishte patur asnjë kontakt me ish bashkëjetuesen. Nuk ishte i nevojshëm lëshimi i urdhërit të mbrojtjes për të, pasi e kishte vendosur që bashkëjetesa me paditesen nuk do të vijonte më, dhe nuk donte të kishte kontakte me të. Thjesht kërkonte që të takonte fëmijën e tyre të mitur.

Vlerësimi i gjykatës.

Gjykata, pas analizës së faktit të sipërcituar, referuar parashikimeve ligjore, konkludon se duhet të vërtetohet urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar në datën 25.03.2026 për paditësen Denisa Mero, dhe duhet të lëshohet urdhri i mbrojtjes për të.

Duke qenë se në themel të këtij gjykimi qëndron kërkimi për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes, analiza gjyqësore e kërkimit do të bazohet në dispozitat e ligjit nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", si një ligj i posaçëm.

Nëpërmjet ligjit 11/2026, ligjvënësi ka parashikuar mjete dhe mënyra të detajuara për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave që cënohen nga dhuna në familje në të gjitha format e saj.

Neni 38 i këtij ligji, ndër të tjera, parashikon:

"1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 35, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata: a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet; b) refuzon lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate; c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 35 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate....."

Neni 5 parashikon:

"1.....c. "Dhunë" është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. c. ""Dhunë ndaj grave"është çdo akt dhune i drejtuar ndaj një gruaje ose një vajze, përfshirë dhunën gjinore kundër grave dhe që prek gratë e vajzat në mënyrë disproporcionale dhe është një formë diskriminimi që sjell ose ka gjasa të sjellë dëme ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, shtrëngimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike, private, përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia". d. "Dhunë në familje" është çdo akt dhune sipas shkronjës "c" të kësaj pike, ushtruar ndërmjet pjestarëve, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji, që ndodh brenda ose jashtë njësisë së banimit mes pjestarëve që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare për shkaqe natyrore ose juridike, sipas përcaktimeve të këtij ligji, dhe pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën."

Kuptimi i formave të dhunës të parashikuara në këtë dispozitë, referuar "Manualit për zbatimin e konventave të Këshillit të Evropës", përfshirë dhe konventën "Për parandalimin

dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" datë 11.5.2011, përcaktohet si më poshtë:

Dhuna fizike përcaktohet një lloj dhune ku një person (ose një grup njerëzish) përdor një pjesë të trupit të tij ose një objekt për të lënduar dikë tjetër, ose për të marrë nën kontroll një viktimë. Dhuna fizike përfshin rrahjen, djegien, shkelmimin, grushtimin, kafshimin, gjymtimin ose vrasjen, ose përdorimin e sendeve ose armëve. Dhuna fizike është një veprim që synon të shkaktojë, ose që rezulton në, dhimbje dhe/ose dëmtim fizik.

Dhuna psikologjike (ndonjëherë e njohur si dhuna emocionale) - një lloj dhune, ku një person (ose një grup njerëzish) përdor qëllimisht intimidimin dhe kërcënimet që çojnë në frikë, duke u mundësuar atyre që të fitojnë kontrollin mbi një person tjetër ose një grup njerëzish. Dhuna psikologjike shpesh paraprin ose shoqëron dhunën fizike dhe seksuale në marrëdhëniet intime (dhuna në familje).

Dhuna seksuale - çdo akt seksual, përpjekje për të marrë një akt seksual, komente të padëshiruara seksuale ose iniciativa, ose veprime për trafikim, ose të drejtuara kundër seksualitetit të një personi duke përdorur detyrimin/intimidimin, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. (burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë).

Dhuna socio-ekonomike - një lloj dhune që synon marrjen nën kontroll të një personi duke i bërë ata të varur ekonomikisht dhe duke zvogëluar rolin e tij në shoqëri.

Dhuna verbale - një lloj dhune që ndodh kur dikush përdor gjuhën për të poshtëruar dhe shkaktuar dëm të një personi, p.sh. thirrje, bërtitje, ofendim, sharje ose kërcënim i formave të tjera të dhunës ndaj viktimës ose kundër dikujt ose diçka të dashur për ta.

Ndërsa me *cënim të integritetit moral*, do të kuptojmë dëmtimet e nderit dhe dinjitetit personal, apo të reputacionit të mirë shoqëror të njeriut. Të tilla janë sjelljet dëmtuese të së drejtës së "emrit të mirë", të imazhit, privatësisë, apo fyerjet, tradhtia bashkëshortore, etj. Duhet theksuar se nuk bëhet fjalë për abuzime psikologjike, të cilat klasifikohen si dëmtime të karakterit psikologji.

Neni 33, ndër të tjera parashikon:

"3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve, si dhe në çdo element tjetër mbështetës të administruar në proçes, në të cilat është kryer dhuna ndaj grave ose dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet. Bindja e gjykatës mbështetet edhe në parimin e mbrojtjes së viktimës dhe vlerësimin e ekspertëve të fushës."

Ligji 11/2026, nga njëra anë përmban dispozita të natyrës materiale, përmes së cilave përcaktohen mekanizmat dhe masat e përshtatshme për të parandaluar dhe reduktuar dhunën në familje dhe nga ana tjetër, dispozita të natyrës procedurale, lidhur me zhvillimin e procesit gjyqësor në përfundim të të cilit caktohen masat mbrojtëse nga gjykata. Pra, bazuar në qëllimin e tij (parandalimi dhe reduktimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje), janë përcaktuar disa përjashtime nga rregullat dhe parimet e përgjithshme të një procesi gjyqësor civil, që lidhen me legjitimitetin aktiv dhe pasiv, standardin e të provuarit, afatet e gjykimit dhe rolin më aktiv të gjykatës në zhvillimin e procesit dhe caktimin e masave mbrojtëse.

Gjykata thekson se është e rëndësishme që dispozitat e këtij ligji të interpretohen në

përputhje me qëllimin, frymën dhe natyrën e veçantë të marrëdhënieve që ai synon të mbrojë.

Lidhur me standardin e të provuarit në këtë lloj gjykimi, për shkak të natyrës së tij, ndryshe nga një proces penal, gjykata evidenton se ai është i tillë që nuk kërkohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Është e mjaftueshme që gjykata të krijojë një bindje qoftë edhe të pjesshme, por të arsyeshme për ekzistencën e dhunës dhe rrezikut të përsëritjes së saj në të ardhmen, gjë që përligj vendosjen e masave të caktuara mbrojtëse.

Duke u kthyer në rastin konkret gjykata çmon se, plotësohen kushtet e kërkuara nga ligji nr. 11/2026, për vendosjen e masave të posaçme në kuadrin e lëshimit të një urdhëri mbrojtje për paditësen. Kjo pasi:

Së pari, referuar neneve 5, 12 pika 2 shkronja "a" të ligjit 11/2026, paditësja, në cilësinë e viktimës së dhunës që bën pjesë në rrethin e subjekteve të mbrojtura nga ligji, ka legjitimitet aktiv në ngritjen e kësaj padie dhe i padituri ka legjitimitet pasiv, në cilësinë e personit dhunues po nga ky rreth subjektesh.

Së dyti, gjatë shqyrtimit gjyqësor pavarësisht se, paditësja në seancën gjyqësore për vërtetimin e urdhërit të mbrojtjes nuk paraqiti prova, referuar pohimeve të saj, të të padituri dhe rrethanave të faktit, rezultoi e provuar se i padituri ka kryer vepër dhune në familje ndaj ish bashkëjetueses së tij, në formën e dhunës psikologjike, në datën 22.03.2026 e në vijimësi gjatë bashkëjetesës së tyre. Këto veprime kanë si shkak mosmarrëveshjet e vazhdueshme mes tyre dhe faktin që padituri konsumon pije alkoolike. Gjithashtu gjykata vlerëson se, ndjenja e vazhdueshme e frikës për sigurinë dhe jetën që përjeton paditësja për shkak të situatës së krijuar nga dhuna psikologjike e ushtruar në mënyrë të përsëritur nga i padituri është e tillë që vështirëson aktivitetin e përditshëm të saj e familjarëve.

Ekzistenca e situatave të përsëritura të dhunës, duke marrë parasysh sjelljen e të padituri, krijon tek gjykata dyshim të arsyeshëm se dhuna psikologjike mund të përsëritet edhe në të ardhmen, dhunë që mund të sjellë pasoja akoma më të rënda për jetën dhe shëndetin e palës paditëse.

Përsa më sipër, për të siguruar mbrojtjen e viktimës, duke qenë se plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e kërkuara nga ligji nr. 11/2026, gjykata çmon se duhet të vërtetohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes datë 25.03.2026 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe të lëshohet urdhëri i mbrojtjes për paditësen Denisa Mero.

Lidhur me llojin e masave mbrojtëse që duhet të caktohen, gjykata, duke mbajtur parasysh rrethanat e faktit konkret, natyrën, shkallën e dhunës së ushtruar dhe nevojat e mbrojtjes së paditëses, vlerëson se duhen caktuar masat e përcaktuara në urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes datë 25.03.2026.

Lidhur me kohëzgjatjen e këtyre masave, referuar nenit 35 pika 5 gërma "b" të ligjit 11/2026, gjykata vlerëson që kohëzgjatja të jetë gjashtë muaj nga data e lëshimit të urdhërit të mbrojtjes, deri në datën 13.10.2026, si një kohë e mjaftueshme që palët të reflektojnë rreth mënyrës së jetesës dhe sjelljes së tyre. Në caktimin e saj gjykata mban parasysh marrëdhëniet konfliktuale midis palëve dhe rrethanat konkrete të faktit.

Gjykata thekson se shkelja e këtyre masave sjell përgjegjësi penale sipas nenit 321 ose 320 të K.Penal.

Referuar nenit 510 të K.Pr.Civile dhe nenit 41 të ligjit 11/2026, ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i detyrueshëm i tij bëhet nga shërbimi përmbarimor gjyqësor konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenit 510 e vijues). Nëse ky vendim ankimohet, bazuar në nenin 39 pika 3 të këtij ligji, paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Referuar nenit 511, shkronja "a" të K.Pr.Civile i ndryshuar, për këtë vendim nuk ka vend që të lëshohet urdhër ekzekutimi por, bazuar në nenin 510 shkronja "a" dhe "b", të K.Pr.Civile, ky fakt do të cilësohet në dispozitivin e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 126, 310 të K.Pr. Civile, ligjin 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje",

VENDOSI:

1. Lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes për paditësen Denisa Mero, duke caktuar masat mbrojtëse, si më poshtë:
   a) Largimi i të padituri Ilir Kallavaresi nga banesa ku paditësja jeton aktualisht në fshatin e Vashtëmi, bashkia Maliq, së bashku me prindërit e saj.
   b) Urdhërimi i të padituri Ilir Kallavaresi që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj paditëses Denisa Mero.
   c) Urdhërimi i të padituri Ilir Kallavaresi që të mos cënojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësen Denisa Mero.
   ç) Ndalimi i të padituri Ilir Kallavaresi që t'i afrohet banesës ku paditësja jeton aktualisht në fshatin Vashtëmi, bashkia Maliq, vendit të saj të punës ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër prej saj, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune.
   d) Ndalimi i të padituri Ilir Kallavaresi që t'i afrohet paditëses Denisa Mero në një distancë prej 10 metra.
2. Kohëzgjatja e këtyre masave është një vit nga data e lëshimit të urdhërit të mbrojtjes pra, deri në datën 13.10.2026.
3. Shkelja e urdhërimeve të këtij vendimi përbën vepër penale në kuptim të nenit 321/2 të Kodit Penal.
4. Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, dy kopje t'i dërgohen paditëses Denisa Mero; një kopje të padituri Ilir Kavallaresi; një kopje Komisariatit të Policisë Maliq; një kopje Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë Maliq dhe një kopje Zyrës Përmbarimore Korçë.
5. Ky vendim është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor dhe Zyrën e Shërbimeve Sociale bashkia Maliq.
6. Kundër këtij vendimi, i padituri mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar dhe paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

U shpall në Korçë, sot në datën 14.04.2026.

SEKRETAR
Guri SOFI

GJYQTARE
Gentiana SHUKULLARI